

CITYFLOW

SINCE 2026



REPORT



**Junior
Achievement
of Albania**

Anëtar i
JA Worldwide

Shkolla: “Kristaq Rama”
Qyteti: Tiranë

Përmbajtja

- Përshkrimi
- Vizioni dhe misioni
- Struktura e kompanisë
- Problemi
- Zgjidhja
- Klienti
- Produkti
- Prodhimi i produktit
- Shitja & Marketingu
- Pasqyra financiare
- Përmbledhje e planit të biznesit

Përshkrimi:

CityFlow është një kompani inovative e krijuar nga nxënës, e cila synon të zvogëlojë trafikun në qytete duke përdorur një sistem inteligjent të bazuar në inteligjencë artificiale. Sistemi analizon të dhënat e trafikut në kohë reale dhe i jep prioritet makinave të emergjencës.

Vizioni & Misioni

Vizioni ynë është të krijojmë qytete më të organizuara dhe më të lëvizshme, ku trafiku të menaxhohet në mënyrë inteligjente dhe efikase.

Misioni ynë është të zhvillojmë një sistem teknologjik që ndihmon qytetarët dhe institucionet të reduktojnë bllokimet e trafikut dhe të përmirësojnë lëvizjen në qytet.

Pse ekziston kompania:

Trafiku është një nga problemet kryesore në qytetet e mëdha. Ai shkakton humbje kohe, ndotje të ajrit dhe stres për qytetarët. CityFlow synon të ofrojë një zgjidhje teknologjike për këtë problem.

Çfarë e bën të veçantë:

CityFlow përdor inteligjencë artificiale me anë të algoritmeve të ndryshme për të analizuar të dhëna dhe për të optimizuar lëvizjen e automjeteve në qytet.

Struktura e kompanisë

Kompania përbëhet nga një ekip prej 5 anëtarësh që punojnë së bashku për zhvillimin dhe promovimin e projektit.



Presidenti



Drejtuese e financave



Drejtuese e marketingut



Drejtuese e marredhënjeve me publikun



Drejtues i prodhimit

Mësuesi mbikqyrës: Elda Dyli

Problemi:

Qytetet moderne përballen me një rritje të vazhdueshme të numrit të automjeteve. Semaforët tradicionalë krijojnë:

- Bllokime të panevojshme në një drejtim ndërsa rruga tjetër është bosh
- Rritje të kohës së udhëtimit
- Konsum të tepërt karburanti Rritje të ndotjes dhe emetimeve të CO₂
- Rrezik më të lartë aksidentesh.
- Në shumë raste drejtuesit e automjeteve nuk kanë informacion të mjaftueshëm për gjendjen reale të rrugëve duke rezultuar në më shumë trafik.

Zgjidhja:

City Flow ofron një sistem semaforesh që funksionon në kohë reale. Përmes analizës së vazhdueshme të trafikut, sistemi identifikon drejtimet me fluks më të lartë, prioritizon automjetet emergjente dhe redukton kohën mesatare të pritjes. Sistemi është i aftë të mësojë nga të dhënat historike dhe të përmirësohet me kalimin e kohës. CityFlow ofron një sistem inteligjent që analizon të dhënat e trafikut dhe ndihmon në përmirësimin e trafikut.

Klientët:

Produkti ynë i drejtohet institucioneve lokale që perfshijnë bashkitë dhe institucionet e transportit

Produkti:

Një sistem hardware dhe software që monitoron trafikun.

Teknologjia dhe Funksonimi

City Flow përbëhet nga disa komponentë kryesorë:

- 1.Kamera me analizë imazhi – Numërojnë automjetet dhe identifikojnë densitetin e trafikut.
- 2.Sensorë inteligjentë – Monitorojnë lëvizjen dhe shpejtësinë.
- 3.Algoritme Machine Learning – Analizojnë modelet e trafikut dhe optimizojnë kohëzgjatjen e semaforëve.
- 4.Sistem IoT – Mundëson komunikim të vazhdueshëm mes pajisjeve



Prodhimi i produktit / shërbimit

Produkti kryesor është vetë semafori bashkë me një platformë digjitale që përdor algoritme të inteligjencës artificiale për të analizuar trafikun në kohë reale.

Sistemi funksionon duke:

- mbledhur të dhëna nga rrugët dhe përdoruesit,
- analizuar trafikun,
- i jepe përparësi makinave të emergjencës siç janë ambulancat apo makinat e policisë.

Kostot kryesore:

Kostot kryesore të biznesit do të bien mbi këto komponentë

- Serverat dhe teknologjia
- Krijimi i produktit
- Marketingu dhe promovimi
- Mirëmbajtja e sistemit

Hapat e prodhimit të produktit	Lista e partnerëve të përfshirë për proces prodhimi	Kostot e prodhimit të produktit
<ul style="list-style-type: none">• Krijimi dhe përshtatja e idesë nga grupi i përzgjedhur.• Krijimi i prototipit 1 që përfshinë mbledhjen e materialeve dhe kodimin e microchips.• Gjetja dhe bashkëpunimi me sponsorat.	<ul style="list-style-type: none">• Shkolla “Kristaq Rama”• Junior Achievement of Albania	<p>Kostoja e prodhimit të prototipit 1 = 10000 lekë</p> <p>Pajisjet teknologjike dhe sistemi AI</p>

Pasqyra financiare

Pasqyra e PASH			
A	TE ARDHURAT		
1	Te ardhura nga kontributet		11000
2	Te ardhura nga shitjet		
3	Te ardhura te tjera		
	Totali i te ardhurave		11000
B	SHPENZIMET		
1	Kosto e materialeve		5800
2	Kosto per punonjesit		0
3	kosto per printime/marketing		5200
C	Totali i shpenzimeve		11000
D	Fitimi para tatimit		0
E	Tatimi 0%		
F	fitimi pas tatimit /te ardhura te mbetura	0	0
Pasqyra e Bilancit			
A	Aktivitet (gjendja ne te holla		
1	Banka/Arka		0
2	hua afatshkurtera nga pjesemarresit		11000
3	inventari		
4	aktive afatgjata		
	Totali i te Aktivit		11000
B	Pasivi-detyrimet		
1	kapitali fillestar vet finacues		11000
2	rezerva ligjore		0
3	fitimi pas tatimit		0
C	Totali i detyrimeve		11000

Shitja dhe marketingu

Strategjia e marketingut:

CityFlow do të promovohet përmes rrjeteve sociale, prezantimeve në shkolla dhe bashkëpunimeve me institucione lokale.

Përhapja e produktit:

Përhapja e produktit do të bëhet nërmjet kanaleve kryesore të shitjes, por edhe nëpërmjet formave tradicionale të marketingut: fletëpalosje, pastera, panaire për promovimin e produkteve etj.. Kanalet përfshijnë aplikacionet Instagram, Facebook dhe gjithashtu mjet komunikimi do të jetë adresa e email-it.

Instagram: [cityflow.development](https://www.instagram.com/cityflow.development)

Facebook: [cityflow_development](https://www.facebook.com/cityflow_development)

E-mail: cityflow.al@gmail.com

Modeli i biznesit:

Biznesi synon ta shesë produktin me anë të shitjeve direkte kundrejt nje institucioni shtetëror, ose shitjeve B2B

Objektivat e shitjes:

Të arrijmë një numër të madh përdoruesish në qytet dhe të krijojmë bashkëpunime me institucione që menaxhojnë trafikun.


Përmbledhja e planit të biznesit

CityFlow është një projekt inovativ që synon të zgjidhë problemin e trafikut në qytete duke përdorur teknologjinë dhe inteligjencën artificiale. Kompania ka një vizion të qartë për të krijuar qytete më të organizuara dhe për të ndihmuar qytetarët të lëvizin më shpejt dhe më lehtë. Produkti kryesor është një semaforë që analizon trafikun dhe i jep përparësi makinave të emergjencës. Me një strategji të mirë marketingu dhe zhvillim teknologjik, CityFlow ka potencial të bëhet një zgjidhje e rëndësishme për menaxhimin e trafikut në qytete.


Let's go with CityFlow



✉ cityflow.al@gmail.com
📱 cityflow_development
📺 cityflow_development



CityFlow
development



Letra e presidentit

Të nderuar aksionerë,

Ne po ndërtojmë CityFlow me një mision të thjeshtë, por shumë të fuqishëm: të rikrijojmë mënyrën si qytetet menaxhojnë trafikun. Sistemet aktuale të trafikut janë të vjetra. Semaforët me kohë fikse nuk reagojnë ndaj kushteve reale, duke shkaktuar bllokime, humbje kohe dhe ndotje të panevojshme. Kjo ndikon çdo ditë tek miliona njerëz.

CityFlow është krijuar për ta zgjidhur këtë problem përmes kontrollit inteligjent të trafikut. Duke përdorur të dhëna në kohë reale nga kamera dhe sensorë, sistemi ynë përshtatet dinamikisht me situatën, optimizon rrjedhën dhe redukton vonesat e panevojshme.

Në fazën fillestare të zhvillimit, kemi ndërtuar një prototip funksional që mund të kontrollojë disa kryqëzime dhe të simulojë sjellje adaptive të trafikut. Kjo vërteton konceptin tonë bazë dhe hap rrugën për zhvillim të mëtejshëm.

Vizioni ynë është ta shndërrojmë këtë sistem në një rrjet të lidhur kryqëzimesh inteligjente, ku çdo pikë komunikon me të tjerat për të optimizuar trafikun në shkallë qyteti. Gjithashtu synojmë integrimin e energjisë së qëndrueshme, si infrastruktura e fuqizuar nga panele diellore.

Jemi ende në fillim, por drejtimi është i qartë. Me burimet dhe strategjinë e duhur, CityFlow ka potencialin të bëhet një faktor kyç në të ardhmen e lëvizshmërisë urbane.

Faleminderit për besimin dhe mbështetjen tuaj.

Me respekt,

President, Arten Barxho

CityFlow

Letra për vullnetarët

Të nderuar vullnetarë,

Ju falënderojmë që keni zgjedhur të bëheni pjesë e CityFlow.

CityFlow është një iniciativë që synon të përmirësojë mënyrën si funksionon trafiku në qytetet tona, duke përdorur teknologji dhe ide të reja për të krijuar një sistem më të zgjuar, më efikas dhe më të qëndrueshëm.

Roli juaj si vullnetar është shumë i rëndësishëm. Çdo kontribut – qoftë në ide, punë praktike apo mbështetje – ndihmon drejtpërdrejt në ndërtimin dhe zhvillimin e këtij projekti.

Si pjesë e CityFlow, nga ju pritet:

- angazhim dhe seriozitet në detyrat e caktuara
- bashkëpunim me ekipin
- respektim i afateve dhe komunikim i qartë

Nga ana jonë, ne angazhohemi të:

- krijojmë një ambient bashkëpunues dhe mbështetës
- ndajmë njohuri dhe përvojë
- ju përfshijmë në zhvillimin real të projektit

Ky është vetëm fillimi. Me përkushtim dhe punë të përbashkët, ne mund të ndërtojmë diçka me vlerë reale për komunitetin dhe më gjerë.

Faleminderit që jeni pjesë e këtij rrugëtimi.

Me respekt,

President, Arten Barxho

CityFlow

Statuti i shoqërisë

Neni 1: Emri dhe Qëllimi i Shoqatës

1.1. Emri: Emri i kësaj shoqate është CityFlow.

1.2. Qëllimi: Qëllimi i kësaj shoqate është të zhvillojë, të prodhojë dhe të komercializojë produktin ose shërbimin i cili përfshin pastrimin e ajrit nëpërmjet filtrit nazal.

Neni 2: Anëtarët dhe Kontributet

2.1. Anëtarësia: Anëtarë të shoqatës mund të jenë individë, kompani, apo organizata që zotërojnë minimalisht 1 aksion te kompanisë.

2.2. Çdo anëtar, i cili mungon në tre mbledhje të njëpasnjëshme do të përjashtohet sipas votave të bordit.

Neni 3: Organizimi dhe Struktura e Shoqatës

3.1. Bordi i drejtorëve: Kontrolli i shoqërisë është i bordit të drejtorëve, i cili përbëhet nga 5 anëtarë të shoqërisë. Një kuorum do të përbëhet nga gjysma e bordit. Një shumicë do të vendosë për çdo pyetje.

3.2. Menaxhimi: Një ekip menaxhimi i përbërë nga presidenti dhe drejtuesi i çdo departamenti do të zbatojë direktivat e bordit.

Neni 4: Financat

4.1. Çeqet duhet të nënshkruhen nga një drejtues dhe të kundërfirmosen nga vullnetari.

4.2. Kompensimi: Paga minimale do të jetë 50 lekë për orë. Paga minimale për drejtuesit do të jetë 200 lekë. Asnjë anëtar i shoqërisë nuk do të paguhet për mbledhjen e parë. Një komision prej të paktën 10% do të paguhet për shitjet.

Neni 5: Ndërveprimi me Entitetet e Tjera

5.1. Licencat dhe Lejet: Shoqata është përgjegjëse për sigurimin e licencave dhe lejeve të nevojshme për veprimtarinë e saj, përfshirë përdorimin e teknologjisë së inteligjencës artificiale (ChatGpt API).

Neni 6: Ndryshimet e Shoqatës

6.1. Ndryshimet: Ky statut mund të ndryshohet me miratimin e një shumice të anëtarëve.

Neni 7: Likuidimi i Shoqatës

7.1. Mbyllja: Shoqata do të likuidohet në përfundim të afatit të operimit prej 12 javësh.

7.2. Shpërndarja e dividendëve: Pas likuidimit, fitimet e shoqatës do të përdoren për të mbuluar detyrimet e saj dhe, nëse është e mundur do t'i kthehen aksionerëve në formën e dividendëve.

Neni 8: Amendime

8.1. Amendime: Këto nene mund të ndryshohen me dy të tretat e votave të bordit të drejtorëve dhe me miratimin e zyrës së Junior Achievement në Shqipëri.